



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI BASHKIAK TIRANË

V E N D I M

Nr.39, datë 20/07/2005

**“MBI MIRATIMIN NË PARIM TË DHËNIES ME QERA TË DISA  
OBJEKTEVE TË NDËRMARRJEVE DHE INSTITUCIONEVE NË  
ADMINISTRIM TË BASHKISË TIRANË”**

Në mbështetje të ligjit Nr.8652, dt.31/07/2000 “Për organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore”, neni 32, gërma “e”, Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr.378, dt.12/08/1999 “Për kalimin e të drejtës së përfaqësuesit të pronarit për disa objekte pronë publike, organeve të qeverisjes vendore”, Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr.315, dt.24/04/2003 “Për dhënien me qera të pasurive të ndërmarrjeve, shoqërive dhe institucioneve shtetërore”, Udhëzimit Nr.4, dt.11/06/2003 “Për dhënien me qera të pasurive të ndërmarrjeve, shoqërive dhe institucioneve shtetërore”, pika 3, gërma “b”, Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr.323, dt.21/05/2004 “Për disa shtesa në Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr.315, dt.24/04/2003 “Për dhënien me qera të pasurive të ndërmarrjeve, shoqërive dhe institucioneve shtetërore”, pika 2, gërma “c”, Udhëzimit Nr.132, dt.18/05/2005 “Për disa ndryshime dhe shtesa në Udhëzimin Nr. 4, dt.11/06/2003 “Për dhënien me qera të pasurive të ndërmarrjeve, shoqërive dhe institucioneve shtetërore”, pika 1, 5, dhe me propozimin e Kryetarit të Bashkisë, Këshilli Bashkiak,

V E N D O S I;

1. Miratimin në parim të dhënies me qera të objekteve me sipërfaqe 200-500 m<sup>2</sup> për një periudhë 5 vjeçare, për disa Ndërmarrje dhe Institucione të varësisë së Bashkisë së Tiranës si më poshtë:

- **Ndërmarrja Elektroteknike**

Objekti “**Reparti i Montimit**”  
Sipërfaqe ndërtimore

Kati i II-të  
**493 m<sup>2</sup>**

- **Uzina Mekanike**

Objekti “**Magazina e Produktit të Gatshëm**”  
Sipërfaqe ndërtimore

Kati i I-rë  
**375 m<sup>2</sup>**

- **Ndërmarrja Metalike “Tirana”**

Objekti “**Reparti i Orëve**”  
Sipërfaqe ndërtimore

Kati përdhe  
**500 m<sup>2</sup>**

2. Miratimin në parim të dhënies me qera të objekteve me sipërfaqe mbi 500 m<sup>2</sup> për një periudhë 5 vjeçare, për disa Ndërmarrje dhe Institucione të varësisë së Bashkisë së Tiranës si më poshtë:

- **Ofiçina e Automjeteve**

Objekti “ <b>Spektori i Paisjeve</b> ”	1 KT
Sipërfaqe funksionale (truall)	<b>504 m<sup>2</sup></b>
Sipërfaqe ndërtimore	<b>380 m<sup>2</sup></b> nga të cilat:

SA (Sektori Mekanik i Repartit të Paisjeve)	<b>136 m<sup>2</sup></b>
---	--------------------------

SB (Sektori i Presave Eksentrike i Repartit të Paisjeve)	<b>244 m<sup>2</sup></b>
--	--------------------------

3. Për zbatimin e pikës 1 të këtij Vendimi të kryhen procedurat e konkurimit publik sipas akteve ligjore dhe nënligjore në fuqi.
4. Për zbatimin e pikës 2 të këtij Vendimi të njoftohet Ministria e Ekonomisë, në cilësinë e pronarit shtet për kryerjen e procedurave të mëtejshme ligjore.
5. Për zbatimin e këtij Vendimi ngarkohen Drejtoria Juridike, Drejtoria e Administrimit të Aseteve, Drejtoria e Buxhetit dhe Administrimit Financiar si dhe Ndërmarrjet: Ofiçina e Automjeteve, Uzina Mekanike, Ndërmarrja Metalike “Tirana”, Ndërmarrja Elektroteknike.
6. Ky Vendim hyn në fuqi 10 ditë pas shpalljes.

**K R Y E T A R I**

**LUAN SHAHOLLARI**